



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 12/2010

Prishtinë më 23.03. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Mursel Halilji, Sala Berisha – Shala, Zef Morina dhe Qamile Morina.

Munguan: Fatmir Rexhepi, Mufëra Şinik, Nerxhivane Dauti dhe Kaqusha Jashari.

Pjesëmarrës të tjerë: Mehmet Krasniqi, kryetar i komunës së Obiliqit, Nexhat Demaku kryetar i komunës së Drenasit, Bill Klawonn dhe Haxhi Gashi – USAID, Isuf Zejna – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 16. 03. 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163,
4. Miratimi i Raportit me rekomandime të Projektligjit për shërbimet postare nr. 03/L-173;

5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja – Propozoj të futet pikë e rendit të ditës Strategjia e energjisë 2009 - 2018 për periudhën 2009 - 2018, sepse së do të jetë në shqyrtim në seancën e radhës.

Sala Berisha – Shala – Propozoj që pika e 4 (katërt) të vendoset në vend të pikës së 3 (tretë) të rendit të ditës, sepse është vetëm një miratim formal i Raportit me rekomandime të Projektligjit për shërbimet postare nr. 03/L-173.

Propozimet u miratuan njëzëri nga Komisioni, që të diskutohet më këtë:

R e n d d i t e

1. *Miratimi i rendit të ditës,*
2. *Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 16. 03. 2010,*
3. *Miratimi i Raportit me rekomandime të Projektligjit nr. 03/L-173 për shërbimet postare;*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163,*
5. *Strategjia e energjisë 2009 - 2018 për periudhën 2009 - 2018.*
6. *Të ndryshme.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16. 03. 2010

Sala Berisha – Shala – Paraqiti vërejtje në pikën III (tretë) të rendit të ditës. Theksoi se te diskutimi rreth kristaleve të Kosovës, duhet të jetë “*Te përfshihen në Projektligjin, kristalet e Kosovës dhe menaxhimi i tyre nga Muzeu i Kristaleve të Kosovës, që për momentin janë në kuadër të kompleksit „Trepça” në Stantërg. Mendoj që kristaleve duhet t’u kushtohet vëmendje institucionale, përkatësisht ligjore, për shkak të nevojës së trajtimit institucional si vlerë muzeale, ashtu që të bëhen edhe mbrojtja, edhe sigurimi i mëtejshëm nga keqpërdorimi dhe shkatërrimi i tyre, që është bërë vite më radhë. Sa për njoftim, Muzeu i kristaleve të Trepçës po ndërtohet me investimin e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të MEM-it dhe të MAPH-it”.*

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16. 03. 2010 miratohet me vërejtjen e deputetes Sala Berisha – Shala.

3. Miratimi i Raportit me rekomandime të Projektligjit për shërbimet postare nr. 03/L-173

Kryetarja – I njoftoi deputetët se Raportin e Projektligjit për shërbimet postare nr. 03/L-173, e kanë shqyrtuar edhe komisionet kryesore të Kuvendit dhe tani i plotëson kushtet sipas ligjit të procedohet për seancë plenare në lexim të dytë.

Përfundim

- Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit për shërbimet postare nr. 03/L-173.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163

Kryetarja – Theksoi se kryesuesja e grupit të punës për Projektligjin për miniera dhe minerale nr. 03/L-163, Sala Berisha – Shala, i paraqet amendamentet për shqyrtim dhe hapi debat.

Sala Berisha – Shala – Si kryesuese e grupit të punës për Projektligjin për miniera dhe minerale, para se t’i paraqiste amendamentet e Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163, propozoi të përfshihen në ligj “kristalet” e Kosovës, në nenin 74 të shtohet një paragraf i ri, sepse paraprakisht ishte pajtuar edhe me deputetët e tjerë të Komisionit dhe më konsulentin.

Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit – E paraqiti paragrafin e ri të nenit 74, të mundshëm për kristalet e Kosovës dhe ndryshimet tek përkufizimet.

Kryetarja – Kërkoj shpjegim më të thellë për këtë çështje, sepse sipas saj vetëm po themelohet një “muze”, por shtoi se është me interes si do të ruhen kristalet.

Ibrahim Krasniqi – Sqaroi se më paragrafin e propozuar MEM-it po i jepet mundësia që me aktënligjor të punojë në këtë drejtim dhe t’i zbatoj politikat e saj.

Sala Berisha – Shala – Shtoi se “muzeu” *de facto* është i themeluar, sepse është në ndërtim e sipër, por më këtë ligj edhe *de jure* po sanksionohet ruajtja kristaleve të Kosovës, sepse aty do të dërgohen të gjitha kristalet nga i tërë vendi dhe do të ruhen. Po ashtu propozoi që edhe në nenin 2 të përkufizimet, të shtohet një paragraf i ri, ku do të shpjegohen pikë për pikë se çka janë kristalet.

Ethem Çeku – Sqaroi së më këtë ligj vetëm po funksionalizohet “muzeu” i Mitrovicës dhe ishte i pajtimit të rregullohet në pjesën e propozuar të ligjit.

Zef Morina – Kërkoj që për kristalet të vendoset me ligj, sikur edhe për të gjitha mineralet e tjera, ndërsa themelimi i “muzeut” të sanksionohet në nenin 74 të ligjit.

Bill Klawonn - USAID – Kërkoj të sqarohet se a flitet për të gjitha kristalet apo vetëm për një kategori, të përfshihet saktë të përkufizimet se cilat kristale, sepse edhe kripa është kristal d.m.th. përkufizimi të jetë në mënyrë eksplicite dhe në nenin të bartësit e licencave. Shtoi se duhet të shikohet me kujdes kjo situatë, sepse Trepça është ndërmarrje shoqërore dhe është nën administrimin e AKP-së dhe duhet të bashkëpunohet më Dhomën së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Ibrahim Krasniqi – U pajtua se duhet të futet dhe të specifikohet qartë në nenin 2 te përkufizimet, por sqaroi se “muzeu”, për të cilin po flitet është “muze” krejtësisht i ri dhe do të quhet “Muzeu Nacional i Republikës së Kosovës”. Është një “muze” i ri, duke u ndërtuar, d.m.th. se nuk ka të bëjë fare me Muzeun e Trepçës.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se duhet të shikohet mirë a ka nevojë për ndërhyrje në nenin për licencat, sepse kompanitë përfituese të licencave janë të detyruara t’i dërgojnë në “muze” kristalet estetike dhe kulturore, pasi që KPMM-ja e ka inspektoratin dhe ai e zbaton ligjin.

Propozimi për amendamentin e ri u miratua në parim nga Komisioni.

Kryetarja – E njoftoi Komisionin se në mbledhje janë të pranishëm: kryetari i komunës së Obiliqit, Mehmet Krasniqi dhe Nexhat Demaku, kryetar i komunës së Drenasit. Ajo ia dha fjalën Krasniqit që t’i paraqiste komentet e tij për Projektligjin.

Mehmet Krasniqi – Shfaqti shqetësimin për mosnjohimin e shqyrtimit të këtij ligji dhe shtoi se komunat janë përjashtuar në tërësi nga vjelja e taksave sa i përket përfitimit të “tantiemat”. Theksoi se duhet të bazohemi në praktikat e vendeve të tjera, kështu që edhe komunat të përfshihen në procesin e përfitimit të taksave për “tantiema”, veçanërisht komuna e Obiliqit dhe ajo e Drenasit.

Ethem Çeku – U pajtua me propozimin e Krasniqit, për mundësinë që edhe komuniteti të jetë përfitues i taksave, në këtë rast Obiliqi dhe Drenasi. Gjithnjë, duke ndarë një vijë buxhetore, në atë mënyrë që të mos dëmtohet interesi kombëtar.

Kryetarja – Ia dha fjalën raportueses Sala Berisha – Shala, të vazhdonte me amendamentet e neni 75 të Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163.

Sala Berisha – Shala – I paraqiti amendamentet më radhë nga neni 75 deri në nenin 88, d.m.th. në fund të Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163, si në vijim: *Amendamenti 59 e ndryshon në tërësi kreun 2 - Shërbimi Gjeologjik; amendamenti 60 ndryshohet pjesa XIII - Dispozitat ndëshkimore dhe mjetet juridike - neni 78; amendamenti 61 e ndryshon nenin 79; amendamenti 62 e ndryshon nenin 80; amendamenti 63 e ndryshon nenin 81; amendamenti 64 e ndryshon titullin e pjesës XIV - Dispozitat e përziera, të përkohshme dhe përfundimtare; amendamenti 65 e ndryshon paragrafin 1 të nenit 83; amendamenti 66 e ndryshon nenin 84.*

Vërejtje:

Amendamenti 59

E ndryshon në tërësi kreun 2 - Shërbimi Gjeologjik

Sala Berisha – Shala – Propozoi të mos ndryshohet paragrafi 1 i nenit 75, d.m.th. të mbetet se Shërbimi Gjeologjik i Kosovës themelohet agjenci në kuadër të MEM-it. Me arsyetimin: *e para*, përderisa puna e këtij shërbimi janë hulumtimet dhe llogaritjet, këto llogaritje i duhen Qeverisë, sepse harton strategji dhe politika zbatuese; *e dyta*, për shkak

se institucionet dhe agjencitë që i themelon Kuvendi deri më sot janë treguar jofunksionale, kështu që edhe më këtë ligj po krijojmë institucione fiktive.

Qamile Morina – E përkrahu idenë, siç është propozimi në amendament, që Shërbimi Gjeologjik t'i përgjigjet Kuvendit, për shkak se e ruan pavarësinë e tij si agjenci.

Zef Morina – Theksoi se Kuvendi është i thirrur më ligj t'i themelojë agjencitë e pavarura dhe ato t'i raportojnë Kuvendit.

Ibrahim Krasniqi – Theksoi ky shërbim mund t'i përgjigjet dhe t'i raportojë kujtdo tjetër. Ai nuk mund të jetë në MEM, sepse nuk është agjenci ekzekutive dhe do të merret me çështje shkencore.

Ethem Çeku – Tha se Kuvendi edhe shteti, kanë probleme me funksionimin e agjencive të pavarura, në veçanti dhe me funksionimin e shtetit në përgjithësi. Bëri thirrje të punohet për forcimin e institucioneve dhe të ruhet pavarësia e tyre.

Bil Klawonn - USAID – Theksoi se këtu po paraqitet problemi për mosfunksionimin e agjencive të pavarura, të cilat i ka themeluar Kuvendi. Problemi qëndronte te Kuvendi, sepse nuk e ushtron mbikëqyrjen e këtyre agjencive. Kuvendi dhe Qeveria duhet t'i ikin logjikës që vetëm të hartojnë dhe të miratojnë ligje. Ato duhet të fillojnë t'i ndalin shkrimet dhe të fillojnë të qeverisin. Për shërbimin gjeologjik, sido që të vendoset, në MEM ose në mënyrë të pavarur, është në rregull, por do të ketë kosto të lartë.

Sala Berisha-Shala – Vuri në pah se kjo agjenci ose duhet të vendoset në nivelin e qeverisjes së MEM-it, ose të mbetet në kuadër të Qeverisë, sepse mund të jetë më funksionale. Njëherësh e kërkoi përkrahjen e të gjithë Komisionit.

Murselj Halilji – Në ç'formë propozohet të jetë në nivel të Qeverisë ose në nivel të MEM-it?

Sala Berisha-Shala – Mund të jetë në nivel të Qeverisë. Në këtë rast të Kryeministrit, si p.sh. Arkivi i Kosovës, ose të bëhet agjenci në kuadër të MEM-it.

Biil Klawonn – Tha se përvoja i njeh tri modele të funksionimit, të cilat janë: Shërbimi Gjeologjik të jetë i pavarur, të jetë në kuadër të KPMM-së ose të jetë në kuadër të MEM-it.

Pas debatit propozimamendamenti u votua më 1 (një) votë Për, 4 (katër) Kundër dhe 1 (një) Abstenim.

Komisioni vendosi që të kalojë amendamenti 59, i propozuar nga grupi i punës.

Sala Berisha-Shala – Deklaroi se propozimamendamentin do ta paraqesë në seancë nëpërmjet Zyrës së Parashtrësive, në bazë të rregullave procedurale.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohen amendamentet e propozuara nga grupi i punës më vërejtjet e paraqitura;*
- II. Procesverbalit i bashkëngjiten amendamentet e miratuara.*

5. Strategjia e energjisë 2009 - 2018 për periudhën 2009 - 2018

Kryetarja – I njoftoi deputetët me përfundimin nr. 03-P-270, të 18. 03. 2010, të seancës plenare, për shqyrtimin e Strategjisë së energjisë 2009 - 2018 për periudhën 2009 - 2018, në të cilin kërkohet që Komisioni në afat sa më të shpejtë të mundshëm t’ia paraqesë Kuvendit rekomandimet. Kërkoi nga Komisioni të formohet një grup pune për hartimin e rekomandimeve për Strategjinë e energjisë 2009 - 2018 për periudhën 2009 - 2018.

Qamile Morina – Tha se duke u bazuar në përfundimin e seancës po kërkohet të ketë opinion të gjerë, të përfshirë në këtë debat: ekspertë vendorë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Kërkoi të mos përfshihet në grupin e punës, për shkak se prej 26 deri më 28 mars do të jetë në një udhëtim zyrtar.

Ethem Çeku – Shtoi se duhet të punohet në përputhje të përfundimit në fjalë dhe së bashku më faktorët e tjerë, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Propozoi të formohet një grup pune që ta hartojë një agjendë dhe t’i ftojë Bankën Botërore, USAID-in, Komisionin Evropian, MEM-in etj.

Kryetarja – Tha se prej Qeverisë, përpos MEM-it, duhet të ftohet edhe MEF-i dhe të nxirret sa më shpejt një rekomandim nga ana e Komisionit.

Sala Berisha – Shala – Vuri në pah se do të jepte kontributin në grupin e punës, por nuk do të përfshihej në atë grup për përpilimin e agjendës.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Përfundim

I Formohet grupi i punës për shqyrtimin dhe hartimin e rekomandimeve për Strategjinë e energjisë 2009 - 2018 për periudhën 2009 - 2018 në këtë përbërje: Myzejene Selmani, Ethem Çeku, Mursel Halilji, Sala Berisha – Shala, Zef Morina dhe Fatmir Rexhepi;

II- Autorizohet grupi i punës të mbajë takime me përfaqësuesit e Bankës Botërore, me USAID-in, me MEM-in - Komitetin Drejtues, me ZRE-në dhe me MEF-in.

4. Të ndryshme

i) Projektligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik nr. 03/L-166

Kryetarja – Kërkoi të njoftohet Nerxhivane Dauti, që të përshpejtohet puna e grupit të punës dhe të paraqitet në Komision Raporti me amendamente.

ii) Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165

Kryetarja – Kërkoi të njoftohet Fatmir Rexhepi që të përshpejtohet puna e grupit dhe të paraqitet Raporti me amendamente në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani